

SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1.	“ Automatikës/Shofer ”,	Rep. Usht. nr.1012, Kukes, FT	Kukës	E pacaktuar	Me dosje	Nuk aplikohet	08.01.2025	22.01.2025

1. Pozicioni i punës: Funkcioni “ Automatikës/Shofer ”, në Repartin Ushtarak nr.1012, Kukës, në Regjimentin e Këmbëtorisë së Veriut, në Forcën Tokësore, me kod vendndodhje A-001, kod grupi B, numër paragrafi 08, numër rendor 004 dhe specialitet LT 2150. Ky funksion ka rëndësi të madhe për të mbajtur në gadishmëri të automjeteve të transportit, realizimin e të gjitha aktiviteteve që lidhen me transportin e personelit, në stërvitje, gatishmëri dhe emrgjenca civile etj.	
2. Kodi i pozicionit: N/C, (Civil II).	
3. Reparti/Institucioni: Reparti ushtarak nr.1012, në Regjimentin e Këmbëtorisë së Veriut, në Forcën Tokësore	
4. Vendi: Kukës	
5. Paga: VKM Nr. 234, datë 20.4.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore” i ndryshuar “Pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.	
6. Lloji i kontratës së punës: E pacaktuar.	
7. Data e fillimit të aplikimit: 08.01.2025	
8. Data e mbylljes së aplikimit: 22.01.2025	
9. Mënyra e aplikimit: Me dosje	
10. Dokumentat e aplikimit: - Kërkesë. - Formularin e aplikimit. - Fotokopje të kartës së identitetit. - Diplomën e shkollës së mesme të noterizuar ose në original. - Fotokopje të lejes së drejtimit të automjetit. - Dëshmi profesioni nëse ka. - Çertifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja. - Raport mjeksor. - Fotografi me përmasa 4x6, 2-copë. - Dëshmi penaliteti. - Vërtetim nga gjykata. - Vërtetim nga Prokuroria. - Librezë pune. - Jetëshkrimin CV. - Formularin e vetëdeklarimit.	
11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës: - Të ketë shtetësinë shqiptare. - Të jetë jo më pak se 18-vjeç.	

- Të ketë kryer detyra si shofer, si dhe të ketë eksperiencë pune mbi 3 vjet.
- Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara.
- Të jetë i aftë për punë nga ana shëndetsore.
- Të mos jetë dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi.
- Të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda një viti nga data e aplikimit

• **Kërkesat specifike të pozicionit të punës:**

- Grada/Titulli: N/C, (CII).
- Arsimi: Të ketë kryer arsimin e Mesëm, preferohen arsimi i mesëm profesional.
- Kualifikimi: Të ketë përvojë pune dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme për vendin përkatës të punës sipas kriterëve të miratuara.
- Trajnimi: Të ketë kryer trajnime të ndryshme në drejtimin e automjeteve të transportit.
- Eksperienca në punë: Të ketë eksperiencë të mëparshme në fushën që mbulon kryesisht në drjetim e automjeteve.
- Gjuha e huaj: nuk proferohet

Kërkesa të tjera specifike:

- Të ketë eksperiencë të mëparshme në fushën e transportit.
- Niveli i çertifikatës së sigurisë: “Nuk ka”.

• **Përshkrimi i punës:**

Funksioni “**Automatikës/Shofer**”, në Repartin Ushtarak nr.1012, Kukës, në Regjimentin e Këmbësorisë së Veriut, në Forcën Tokësore, me kod vendndodhje A-001, kod grupi B, numër paragrafi 08, numër rendor 004 dhe specialitet LT 2150. Ky funksion ka rëndësi të madhe për të mbajtur në gadishmëri të automjeteve të transportit, realizimin e të gjitha aktiviteteve që lidhen me transportin e personelit, në stërvitje, gatishmëri dhe emrgjenca civile etj.

- Ka varësi direkte nga Komandati i skuadrës dhe i togës.
- Të njohë dhe të përdorë mjetet që ka në përdorim.
- Të njohë, zotërojë e të mbajë në gadishmëri mjetin që ka në ngarkim.
- Të zbatojë në kohë detyrat për transportimin e materialeve, sipas rregullave përkatëse.
- Të jetë i pajisur me të gjitha dokumentat e përcaktuara në kodin rrugor të Republikës së Shqipërisë (LDD).
- Të njohë e të zbatojë në çdo kohë kërkesat e kodit rrugor të Republikës së Shqipërisë.
- Të mos përdor mjetin që ka në ngarkim kur nuk i janë kryer nivelet e mirëmbajtjes të radhës, si dhe kur ka defekte e mangësi në kompletim, që nuk sigurojnë punën normale të mjetit.
- Të ketë njohuri në dhënien e ndihmës së parë në raste kur është e nevojshme.
- Të njohë teknikat e transportimit të të dëmtuarve.
- Të marrë pjesë në operacionet e emergjencave civile në ndihmë të popullsisë në zonat që janë përgjegjësi e batalionit Kukës.
- Të njohë dhe të dijë të përdorë armën e zjarrit.

Përgjegjësitë: Ndjek dhe zbaton detyra të ngarkuara nga Komandanti i repartit ushtarak nr.1012.

Përgjigjet për zbatimin e rregullave gjatë përdorimit të mjeteve.

Përgjigjet për kryerjen e detyrave për transportin e trupës, materjaleve, armatim-municion etj.

• **Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3-(tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- Përzgjedhjen paraprake.
- Vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Tokësore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Komisioni, me mbylljen e aplikimeve, verifikon dokumentacionin e aplikantëve nëse ai është i plotë dhe i saktë si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Kandidatët njoftohen nëse janë përzgjedhur ose jo për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- Vlerësimin e dokumentave të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës, të lidhura me fushën përkatëse).

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, kandidatët listohen sipas listë meritës. Pas listimit të 3-tre kandidatëve, i paraqitet autoriteteve kompetente një memo miratuese për përzgjedhjen e kandidatit më të përshtatshëm.

Me emërimin në pozicionin e punës, do të lidhet kontrata individuale e punës.

SHEFI I DEGËS SË PERSONELIT

N/Kolonel Xhemil Hurdha